




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.514/2023
Datë: 27 nëntor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe 33 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 2 të Rregullores Nr. 07/2017 për Organizimin dhe Funkionimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, në takimin 317-të, të mbajtur më 27 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet rekomandimi i Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, i datës 8 nëntor 2023, për publikimin e shkaqeve të dështimit të seancave gjyqësore.
- II. Autorizohet Komisioni për Administrimin e Gjykatave, të ndërmer të gjitha veprimet lidhur me hartimin e aktit dhe përcaktimin e veprimeve procedurale, që duhet t'i paraprijnë zbatimit të këtij rekomandimi.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 nëntor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka shqyrtuar rekomandimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, nga takimi i datës 8 nëntor 2023, për obligimin e gjykatave lidhur me publikimin e shkaqeve të dështimit të seancave gjyqësore.

Publikimi i shkaqeve të dështimit të seancave gjyqësore i ofron qasje publikut nga jashtë, duke fuqizuar edhe më tepër transparencën e gjyqësorit ndaj publikut, si dhe rritjen e llogaridhënies – përkatësisht ngritjen e nivelit të përgjegjësisë së gjyqtarëve.

Me qëllim të publikimit të shkaqeve të dështimit të seancave gjyqësore, përfshirë aktin dhe procedurat që duhet t'i paraprijnë zbatimit të rekomandimit të Asamblesë, KGJK në takimin e 317-të, të datës 27 nëntor 2023, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGA

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Kryesuesit të Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
- Komisionit për Administrimin e Gjykatave;
- Sekretariatit të KGJK-së;

